



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**  
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /**  
**Ministry of Culture, Youth and Sports**

---

**17.03.2025, Prishtinë**

**Thirrje për aplikim**

Bazuar në Thirrjen publike për mbështetjen e autorit për vitin 2025 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, shpallur më datë 07.03.2025 në përputhje me Nenin 8, paragrafin 3.2 të Rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, ftojme organizatat jo qeveritare/shoqërinë civile/njohësit e fushës së librit dhe kulturës, të aplikojnë për të marrë pjesë në komisionin e vlerësimit, në cilësinë:

- përfaqësues nga OJQ-të

- përfaqësues në cilësinë e njohësit të fushës së letërsisë, librit dhe kulturës

Të drejtë aplikimi kanë:

1. Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
2. Njohësit e fushës së letërsisë, librit dhe kulturës.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një CV;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Përfaqësuesi nga OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga Udhëheqësi i OJQ-së në të cilën dëshmohet se aplikuesi është i punësuar apo i angazhuar në organizatë.

Përfaqësuesit e lartpërmendur do të jenë anëtarë të Komisionit vlerësues për vlerësimin e projekt-propozimeve nga thirrja publike mbështetjen e autorit për vitin 2025 të pranuar nga organizatat jo qeveritare (OJQ) sipas thirrjes publike të datës: 07.03.2025.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: [Tylaj.shilek@rks-gov.net](mailto:Tylaj.shilek@rks-gov.net) dhe [dafina.rexhepi@rks-gov.net](mailto:dafina.rexhepi@rks-gov.net) deri me datën 28.03.2025 dhe të shkruhet në **subjekt pozitën për anëtar të komisionit për të cilin aplikoni.**

MKRS-ja do të vlerësojë të gjitha aplikacionet e pranuar dhe do të përzgjedhë një kandidatë nga OJQ-të dhe një nohës të fushave të lartpërmendura, që do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues të thirrjes publike në fjalë.

Pagesa për pjesëmarrje në komision për secilin anëtarë të përzgjedhur do të jetë 500.00€.